



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Lavërtari-Perimtari

Programi: Shkenca Bimore

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Fatbardh Haziri, me titull: “Hulumtimi i disa materieve minerale në specien e Kamomiles (*Matricaria chamomilia* L.) në lokalitetin e Obiliqit” ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 27.11.2024 deri me datë 05.12.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Sali Aliu- kryetar,
2. Prof. Dr. Imer Rusinovci-mentor/anëtar dhe
3. Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Zeka- anëtar,

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Imer Rusinovci, përmes e-mail adresës imer.rusinovci@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
PROGRAMI STUDIMOR: SHKENCA BIMORE



“Hulumtimi i disa materieve minerale në specien e Kamomiles (*Matricaria chamomilia L.*) në lokalitetin e Obiliqit”
(Punim diplome)

MENTORI:
Prof. Dr. Imer Rusinovci

STUDENTI:
Bsc. Fatbardh Haziri

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Mjekësia bashkëkohore botërore ka një prirje strategjike për të kaluar drejt burimeve natyrore me më shumë kërkime për prodhimin e ilaçeve të reja, që vijnë nga bimët mjekësore aromatike. Bimët mjekësore jo vetëm në periudhën e kaluar, por edhe në ditët e tanishme mbeten burimi dhe pasuria më madhe e njeriut, në luftën kundër sëmundjeve të ndryshme. Andaj, e ndërmorrëm këtë studim, që të fokusohemi në vetitë e çmuara të bimes së Kamomilit (*Matricaria chamomilia L.*). Qëllimi i hulumtimit është përcaktimi i përmbajtjes së elementeve minerale: Fe (Hekurit), Ca (Kalciumi), Zn (Zinkut), dhe Mn (Manganit) në rajonin e Obiliqit të bima e kamomilit. Përveç analizave kimike për përmbajtjen e elementeve minerale, qëllim i punimit është edhe përmbajtja e vajit eterik të bima e Kamomilit (*Matricaria chamomilia L.*) në rajonin e Obiliqit. Për realizimin e këtij hulumtimi janë marrë 20 mostra standarde të bimës së Kamomilit (*Matricaria chamomilia L.*), në kushtet agro-ekologjike të lokalitetit të Obiliqit (në fshatin Breznicë të Komunes së Obiliqit). Analiza e variancës për parametrat e hulumtuar dha vlerë të probabilitetit lartë sinjifikante për të dy nivelet $p= 0.05$ dhe 0.01 . Hulumtimet tona treguan se me përmbajtje të lartë ishte $Ca = 2127.4 \text{ mg kg}^{-1}$, ndërsa më të ulët ishte Zinku (Zn) $= 3.94 \text{ mg kg}^{-1}$. Përmbajtjen e vajit eterik më të ulët e realizuan mostrat e para në raport me mostrat tjera (0.8 % dhe 0.9 % të fillimit, ndërsa 1.0 % dhe 1.2 % mostrat e radhës.

Fjalët kyçe: Kamomila, materie minerale, mostrat e marra, parametrat kimik.
